

REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERI - VLADA - GOVERNMENT
 SEKTORI I ARKIVIT - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR

011
 No. Dreg. / Reg. No. 1059-22
 76
 Data / Datum / Date 18 / 04 / 2018



REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE / MINISTARSTVO ZA DIJASPORU I STRATEŠKE INVESTICIJE / MINISTRY OF DIASPORA AND STRATEGIC INVESTMENTS

Njësia Org. / Org. Jedinen / Org. Unit 013
 Nr. i Fajve / Br. Stranica / No. Pages 24
 Nr. i Post. / Broj. Post. / Post. No. 353
 Data / Datum / Date 10.04.2018

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveri - Vlada - Government

Ministria e Diasporës dhe Investime Strategjike / Ministarstvo za Dijasporu i Strateške Investicije / Ministry of Diaspora and Strategic Investments

REFERENCË:		Kryeministër i Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj
PËR/ZA/TO:		
CC:		Dardan Gashi - Zv. Kryeministër/Minister i Diasporës dhe Investimeve Strategjike
PËRMES/PREKO/THROUGH:		
NGA/OD/FROM:		Çerim Bajrami – Zëvendësministër i Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Disa nga aktivitetet të rëndësishme nga Zëvendësministrja i Ministrisë së Diasporës dhe Investime Strategjike z. Çerim Bajrami:
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	107	Lokacioni: Kucni: Extension: Zenel Salihu nr. 1
		Datum: Date:
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION		X
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION		
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE :		



Disa nga aktivitetet të rëndësishme nga Zëvendësministri i Ministrisë së Diasporës dhe Investime Strategjike z. Çerim Bajrami.

Nga tetori 2017 deri 10.04.2018.

Bashkëngjitur: Planin e punës parimor i cili është i dorëzuar në muajin nëntor, 2017 Zv. Kryeministrit/Ministrit e MDIS, z. Dardan Gashi.

Disa nga aktivitetet të punës, të zv. Ministrit të MDIS, z. Ćerim Bajrami.

Me vajzën e Heroit Kombëtar Sefko Salković në Prishtinë, e cila ishte në vizitë te zv. Ministri, me nënën e saj, tetor 2017.




Me datën 28. 10. 2017. Ftesa nga Dzemat Sabur në Munchen (Ingolstadt).



Në këtë manifestim mora pjesë për bashkëpunim reciprok ndërmjet MDIS dhe Shoqatës kulturore "Sabur" në manifestimin e tyre në Ingolstadt 50 km afër Mynhenit.

Ne këtë ngjarje janë të pranishëm një pjesë i konsiderueshëm nga Komuniteti Boshnjak, preardhjen nga Republika e Kosovës.


Me datën 26. 10. 2017. Takimi me z. Sulejman Ugljanin në Prishtinë.




Me rastin e konferencës rajonale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve joshumicë, të organizuar nga Këshilli konsultativ i Kosovës i komunitetit të Kosovë në Prishtinë, si zëvendësministër, takim të me z. Sulejman Ugljanin, kryetar i BNVS dhe z. Mirsad Dzudzević nga Këshilli boshnjak i Malit të Zi.

Arsyeja e takimit ishte: Shkëmbimi i mendimeve u zhvilluan në drejtimin të bashkëpunimit të mundshëm miqësor në rrethanat e caktuara - ndërmjet boshnjakëve në Republikën e Kosovës dhe boshnjakëve nga Sanxhaku dhe me boshnjakët në Republikën e Malit të Zi.

Me datën 01. 11. 2017. Biseda në studion RTK 2, në programin e mëngjesit.



Me datën 02. 11. 2017. Në drejtim forcimi i lidhjes Kosovë – Bosnjë dhe Hercegovinë.



Në MDIS ishte z. Muharrem Zejnullahu, diplomat i BeH nga karriera dhe konsuli i nderit i Republikës së Shqipërisë në Bosnje dhe Hercegovinë.



Arsyeja e takimit: Bashkëpunimi i mëtutejshëm ndërmjet MDIS dhe Shoqatave në Sarajevë.

Kemi diskutuar veçanërisht për regjimin e rreptë të vizave, dhe mosnjohjen e dokumentëve personale të Kosovës në BiH.

Me datën 07. 11. 2012. Biseda direkte në emisionin e Radio Dugagjini.

duk agjini
Radio

Me datën 08. 11. 2017. Takimi me Ministrin e Infrastrukturës z. Pal Lekaj Ministri i Infrastrukturës.




Vizita në teren bashkë me Ministrat Lekaj dhe Demiri.


Kemi zhvilluar një bisedë me Ministrin e Infrastrukturës z. Pal Lekaj në vend të ngjarjes, lidhur me realizimin e projektit të një tuneli të hapur (galeri betoni) në grykën „Duv“ në rrugën rajonale Prizren - Brezovicë, duke filluar nga „Krk'bunar“, afër Prizren.

Me datën 17. 11. 2017. AGJENDA, Raporti: “Buxhetimi për përmisimin e barazisë gjinore në programet për Diasporën”.

Arsyeja ishte: Bashkëpunimi i MDIS me rrjetin e grave të Kosovës, dhe raporti i prezentuar para opinionin dhe medijave në hotel “SIRIUS”. Prishtinë.




Me datën 22. 11. 2017. Biseda live në TV “Koha Vizion” në Prishtinë.




Arsyeja e bisedës ishte: Debat lidhur me gjykimin e kriminelit Ratko Mlladiçit.

**Takim me përfaqësuesit e lartë të OSCE - së, në MDIS, fillimi i dhjetorit 2017,
në lidhje me bashkëpunimin.**



Nga data 22. 12. 2017. – 24. 12. 2017. Ftesa nga Shoqata kulturore “SCHAR”
Wallisellen/Schlieren në Zvicër.



Arsyeja e udhëtimit: Qëllimi i këtij manifestimi ishte forcimi i komunitetit
boshnjakë me diasporën, dhe vizita në shkollën boshnjake në Bern.




Nga data 13. 01. 2018. – 15. 01. 2018. Ftesa nga Shoqata kulturore “Dzemat Bern” Zvicër, dhe me pagesën e tyre shpenzimet e fjetjes dhe transporti i mbrendshëm.

Arsyeja e udhëtimit ishte: Në këtë manifestim kanë marrë pjesë fëmijët me preardhjen nga Republika e Kosovës.


Poashtu, dorëzimi i literaturës (librat) në gjuhën boshnjake nga MDIS, në bazë të kërkesës së tyre.




Me datën 25. 01. 2018. Biseda me gazetarin, Refki Alija, në MDIS, i cili ishte për vizitë te z. Çerim Bajrami.



Me datën 25. 01. 2018. Takim në MDIS me përfaqësuesit e komunitetit boshnjak nga Istogu, për vizitë te z. Çerim Bajrami.





Takimi me drejtorët e KEDS – it, dhjetor 2017 në Prishtinë, bashkë me përfaqësuesit tjerë nga Komuniteti Boshnjak.





Arsyeja e takimit: Biseda ishte lidhur me punimet për linjat e transmetit (rrufe pritës) në katër fshatra në regjionin e Zhupës.



Me datën 27. 01. 2018. Takim me përfaqësuesit e Zhupës në restaurant „Fuad – AS“ në Reçanë.




Me datën 12. 01. 2017. Duda Balje, Bahrim Shabani, Çerim Bajrami dhe Memiș Birdaini në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për kërkesat për mbrojtjen e mjedisit në regjionin e Zhupës, Prizren.



Me datën 04. 02. 2018. Vizita në teren pas përmbytjeve (vërshimeve), për dëmet katastrofale në Zhupë – Nebregoshtë.




Me datën 05. 02. 2018. Biseda në RTK 2.




Me datën 08. 02. 2018. Kryetari i bashkisë së Klosit vizitoi MDIS-in.

Në Ministrinë e Diasporës dhe të Investimeve Strategjike sot ishin për vizitë përfaqësuesit e grupit folklorik "Petalba" nga bashkia e Klosit, rrethi i Matit në Shqipëri. Në mesin e tyre ishin Basir Çupa, kryetari i bashkisë së Klosit; Ildi Punavija, kryetar i grupit folklorik "Petalba"; Hamdi Hysulca, kryetar i klubit letrar "Pjetër Budi" në Mat, dhe Fatmir Neli, gazetar i televizionit "Mat".



Me datën 13. 02. 2018. Takim joformal në MDIS ishte Ambasadori jo-rezident i Bosnjës dhe Hercegovinës në Shqipëri z. Nusret Čančar.



Raporti nga zv. Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike z. Çerim Bajrami në Sarajevë / BeH

Festimi i dhjetë vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës, në Sarajevë, BeH.

Në bazë të ftesës nga Komuniteti Shqiptar në BeH, zv. Ministri i MDIS z. Çerim Bajrami, me kërkesën e miratuar nga Ministri, qëndroj në Sarajevë nga data 16 – 20 Shkurt 2018.

Transporti ishte organizuar nga transport tokësor, makina e tij zyrtare dhe shoferin, përmes Shqipërisë dhe Malit të Zi deri kufiri i BeH, (Šćepan Polje), kurse nga kufiri me transport të automjetit të marrëveshjes së mëparshme.

Gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tij, ishte shoqëruar me z. Muharem Zejnullahu, kryetar i Komunitetit të Shqiptarëve / BeH dhe Konzul i nderit të Republikës së Shqipërisë në Bosnje, dhe ishte i pranishëm në shumicën e vizitave zyrtare të zv. Ministrit.

Aktivitetet kryesore gjatë vizitës në Bosnje:

Sarajevë, 18. 02. 2018. Tryezë e rrumbullakët në Sarajevë e organizuar nga Komuniteti Shqiptarë në Bosnje dhe Hercegovinë mbi marrëdhëniet Boshnjakë - Shqiptarë, me rastin e 17 shkurtit dhe 10 vjetorit të pavarësisë së Republikës Kosovës.

Në takim kanë marrë pjesë shumë intelektual politik, përfaqësuesit nga BeH, Shqipëtarë dhe Boshnjakë

Poashtu me datën 17. 02. 2018. Intervist për MTV "Igman" emisioni i njohur "Sinqerisht e ndershme", prej 1 ore, ishte mysafiri z. Çerim Bajrami, zëvendësministër.

17. 02. 2018. Pas dite - Takim me dy biznesmen në Sarajevë në objektet e tyre, të cilët janë me preardhje nga Prizreni dhe Gostivari: dr. Dzemo Asllani dhe Dino Miftari.

18. 02. 2018. Ora 15:30 – 16:15h – Biseda direkte në studio Radio BIR me gazetarin Bajro Perva.

18. 02. 2018. Ora 19:00h – Pjesëmarrje në festë me rastin e 10 vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Zv. Ministri Bajrami kishte fjalim përshëndetje (në gjuhën boshnjake dhe shqiptare). Festa ishte organizuar nga Komuniteti Shqiptar në hotelin Ilidza, Sarajevë.

Në tubim ishin të pranishëm Shqiptarët që jetonin në shumë qytete të Bosnjës, dhe një pjesë Boshnjakë.

19. 02. 2018. Në ora 10:30h - zëvendësministri i MDIS z. Çerim Bajrami dhe Drejtori i Punëve të Jashtme të Bosnjës në BeH, z. Razim Čolić, diskutuan rreth bashkëpunimit institucional, kulturor - fetar dhe fokusi i diskutimit ishte "edukimi".

Poashtu me datën 19. 02. 2018. - Takim zyrtar me ministren për të drejtat e njeriut dhe refugjatëve të Bosnjës dhe Hercegovinës z. Semiha Borovac.

Biseduan rreth tre temë kryesore: njohjen e dokumenteve të Kosovës nga Qeveria e BeH, heqja e regjimit të vizave, dhe ndihma për boshnjakët e Kosovës në arsimit në gjuhën boshnjake në Kosovë, dhe në mësim plotësues në diasporë.

Në ora 14:00h kthimi prej Sarajevës për në Kosovë.



Arritja në Prizren me datën 20. 02. 2018. në ora 02:15h pas mesnate!

P.S.


Ka pasur një përfaqësim të mirë në Sarajevë nga tryeza e rrumbullakët e 17 Shkurtit.

Dhe disa portale në Kosovë e kanë publikuar atë tubim.

1. Tryeza e rrumbullakët:



2. Festa:



3. Drejtor i punëve të Jashtme të Bashkësisë Islame në BeH, z. Razim Čolić:




4. Takim me ministren për të drejtat e njeriut dhe refugjatëve të Bosnjës dhe Hercegovinës z.
Semiha Borovac:



Me datën 06. 03. 2018. Ishte në MDIS për vizitë z. Faridin Skenderi.



Me datën 06. 03. 2018. Ishte në MDIS për vizitë z. Mustafa Skenderi.



Me datën 09 .03. 2019. ZËVENDËS MINISTRI I DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE z. ÇERIM BAJRAMI NË MANIFESTIMET TË DIASPORËS NË SHTUTTGART


Ishte mbajtur festa e diasporës në Shtutgart, Gjermani të shtunën e kaluar, kryesisht me Boshnjakët e Kosovës.

Manifestim u organizua nga z. Zeçir (Zeko) Shaipi dhe gjithashtu pjesëmarrësi ishte kryetari i KUD 'Šarski Behar' Edis Mustafić, dhe këngëtar i famshëm Anel Rustemi.


Ishte gjithashtu i pranishëm Ministri Rasim Demiri.

Në adresat e tyre mirëpritëse, ne theksuam nevojën që Boshnjakët nga Kosova në një numër të madhë në diasporës në qytetin e Shtutgartit të qëndrojnë së bashku, "të bashkëpunojnë me Shqiptarët nga Republika e Kosovës, të lidhen me Boshnjakët me preardhje nga Bosnja dhe Hercegovinë".

Unë gjithashtu nënvizova pashmangshmërinë e nevojës për kontakte me Konzulin e Republikës së Kosovës në Shtutgart dhe gatishmërinë për bashkëpunim institucional me Ministrinë e Diasporës dhe Investimet Strategjike të Republikës së Kosovës.



KONCERT 10 MARS 2018




Me datën 10. 03. 2018. POASHTU ZV. MINISTRI Z. ÇERIM BAJRAMI VIZITOI EDHE „SHOQATËN KULTURORE“ TË KOMUNITETIT BOSHNJAK, NË SHTUTTGART

Nga takimi i sotëm me kryetarin dhe udhëheqësin Kulturor të Komunitetit Boshnjak të Kosovës në Shtutgart, Gjermani.


Informacioni ka shkëmbyer dhe ka zhvilluar biseda shumë të dobishme për bashkëpunim midis kësaj Ministrie, përkatësisht ndërmjet diasporës dhe Kosovës amë.

Gjithashtu, në emër të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike të Republikës së Kosovës u dorëzuan një numër të madhë të librave të mirë në gjuhën boshnjake për bibliotekën e kësaj shoqate.



Me datën 23. 03. 2018. Në MDIS ishte studenti z. Fatlum Gashi, student që studion në Universitetin e Oksfordit - Angli, për intervist me z. Çerim Bajrami.

Arsyeja e takimit ishte: Specifikisht, jam duke analizuar rolin e diasporës K-Shqiptare në lëvizjen për Pavarësi të Kosovës. Me specifikisht, roli që diaspora ka luajtur para, pas dhe gjatë konfliktit në Kosovë.





Me datën 27. 03. 2018. Në MDIS, vizita e delegacionit nga diaspora nga Gjermania nga Kryetari i shoqatës së Ashkalive në München dhe Kryetari i degës së PDAK-së në Düsseldorf.


Në takim morën pjesë zv. Ministri i MDIS z. Çerim Bajrami, Këshilltari i Ministrisë të MDIS z. Gani Elshani dhe Kryetari i PDAK, deputeti z. Danush Ademi, ky takim u mbajt në sallën e takimeve në MDIS.




Me datën 01. 04. 2018. Zv. Ministri i MDIS z. Çerim Bajrami ishte i pranishëm në Lubinjë e Poshtme, u mbajt përkujtimore shëhid të pushkatuar në Bar (Mali i Zi). Të rinjtë, të pafajshëm, duhej të vdisin, dhe vetëm se ata filluan të jetojnë.



Me datën 04. 04. 2018. Në MDIS, për vizitë ishte z. Mejdin Saljji, profesor në Universitetin e Prizrenit, dhe anëtar i Komisionit të pavarur për media.





Me datën 04. 04. 2018. Ishte z. Gani Elshani, Këshilltar i Ministrisë së MDIS, takoi zv. Ministrin e MDIS z. Çerim Bajrami, ku u diskutua për një bashkëpunim të përbashkët, në aktivitetet e përbashkëta në diasporë të komunitetit Ashkali dhe Boshnjakë.



Me datën 04. 04. 2018. Përfaqësues të Koalicionit të Vakaitit, ishin për vizitë te z. Pal Lekaj. Përgatitjet e përfunduara për fillimin e punimeve në rrugën Prizren – Reçanë

Tema e bisedës ishte fillimi i punimeve të tunelit, parcela e parë nga krk bunar deri reçanë, ku edhe pjesa më e madhe e këtij vendi është në rrezik për të gjithë qytetarët e Kosovës.




Me datën 08. 04. 2018 Zv. Ministri z. Çerim Bajrami morri pjesë në manifestim, për nder të ditës së Romëve.

Rishqyrtimi i rregullt për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Diaporrën dhe Mergatën, poashtu rishqyrtimi për ndryshimin dhe plotësimin e Strategjisë për Diasporën.

10. 04. 2018.

Zv. Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike



Propozim për Plan Programi i punës i zëvendësministrit të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Çerim Bajrami.

Në parim:

REPUBLIKA E KOSOVËS MINISTRI E DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE	
Njësia Org. Org. Jeshore Org. Ujore	01-3
Nr. Faqeve Bil. Stranica No. Pages	04
St. Prot. Prot. No.	353-1
Datum Date	10.04.2018

Komunikimi i rregulltë dhe konsultimi me Ministrin dhe kabinetin të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike.

Pjesëmarrje e rregulltë në të gjitha ftesat dhe detyrimet për aktivitetet brenda dhe jashtë MDIS, në Kosovë.

Rekomandimet për stafin civil të MDIS, në kuadër të ligjit dhe rregullave të Ministrisë, mbi shpërndarjen e fondeve nga buxheti i MDIS për kërkesa për subvencionimit dhe aktivitetet e shoqatës së diasporës dhe nga komuniteteve joshumicë të Republikës së Kosovës në diasporë dhe në vend.

Marrja në pjesë në emër të MDIS në disa nga manifestimet në diasporë jashtë vendit, në bazë të nevojës dhe ftesat e shoqatës së diasporës ose institucioneve jashtë vendit, veçmas atyre nga komunitetet joshumicë.

Deklaratat në media në gjuhën shqipe veçmas në media në gjuhët joshumicë, gjuha boshnjake dhe gjuhët të tjera, në Kosovë dhe jashtë vendit, në lidhje me aktivitetit të MDIS, në përputhje me politikën e Ministrisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Veçanërisht:

Shqyrtim propozim për ndryshime dhe plotësime të ligjit për diasporën dhe emigracionin, rekomanduar nga MDIS.

Studimi i raporteve të MDIS mbi regjistrimin e diasporës dhe emigracionit dhe duke u konsultuar me departamentin të MDIS, përshkak të numrit të vogël regjistruarve të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në diasporë, me qëllim të bërjes së rekomandimeve për ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm në tërheqjen e anëtarëve të komuniteteve joshumice nga diaspora, me qëllim që t'u përgjigjet masovisht regjistrimit në formë online.

Përfshirja në të gjitha planet dhe aktivitetet e Ministrisë në vitin 2017, dhe vitet pasuese, në lidhje me projektet afatshkurtra dhe afatgjata dhe bërja e propozimeve për aktivitetet e pjesëtarëve të komunitetëve joshumicë në diasporë dhe në vend.

Përfshirja në data bazë e Ministrise dhe shoqatat e komuniteteve joshumicë jashtë vendit.

Përgagjitja e propozimeve për asistencë për asociacionet jashtë vendit për të vazhduar me rrjetëzimin dhe komunikimin me MDIS, së Republikës së Kosovës, duke përfshirë rrjetet e të rinjëve nga komunitetet joshumicë, duke nisur nga Cyrihu në Zvicër dhe Sarajevë në BiH.

Përgagjitja e propozimeve në përputhje me dispozitat e ligjit të MDIS, për një planprogram të shkurtër dhe për një kornizë për TRE TEKSTET për të gjitha tre nivelet e mësimit plotësues në gjuhën boshnjake në diasporë, brenda kornizes të planprogrami të përgjithshëm për këtë lloji mësimi jashtë vendit.

Përmbajtja në tekste do të kenë informacion mbi gjeografinë dhe historinë e shkurtër të Republikës së Kosovës, historinë e popullit shqipëtar dhe komunitetëve të tjera, me një referencë të veçantë të komunitetit boshnjak të Republikës së Kosovës. Këto përmbajtje do të korespondojnë me moshën e nxënësve, duke respektuar të gjitha standardet pedagogjike.

Këto libra do të përdoren si shtesë për fëmijët boshnjakë të cilet kanë preardhje nga Republika e Kosovës, në mësimin plotësues në gjuhën

boshnjake në diasporë, si literaturë minimale nga vendi ynë. (Ndërsa literaturë të tjera për këtë lloji mësimi mund të përdorin nga shteti i Bosnjës dhe Hercegovinës, sepse në disa qendra ligjëratat mbahen të përbashkëta për të gjithë fëmijët boshnjakë në diasporë në "Bosanske Škole")

Verejtje: Sipas nevojës eventualisht më vonë, ishin bërë programe të njejta dhe tekstet shkollore dhe për grupet të tjera dy-tre komunitetëve joshumicë të Republikës së Kosovës në diasporë.

Koordinimi mes stafit politik, dhe stafit civil, Qendërave kulturore të MDIS, dhe shërbimet diplomatike, lidhur me rritjen e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të komunitetëve joshumicë gjatë mbajtjes së manifestimeve të datave të rëndësishme të Republikës së Kosovës, veçmas jashtë vendit.

Ndihma të rregullta për të gjithë personat në diaspora, lidhur me problemin të regjistruar dokumentacionit të tyre personal dhe komunikimi me autoritetet kompetent në vend dhe konzullatat të Republikës së Kosovës, si dhe për pyetjet të tjera që janë në mbikçyrje të MDIS.

Propozimi i ndihmave nga MDIS për diasporën në Bosnjë dhe Hercegovinës, e cila është e përbërë prej afër 10.000 shqiptarë, dhe rreth 7.000 boshnjakë nga Kosova, në kontekstin e një problemi të madhë: rezhimit të vizave midis dy shteteve.

Ndihmë për të gjithë të interesuarit biznesmen dhe investitorë nga diaspora për investimet eventuale në vendlindje në Republikën e Kosovës.

Duke marrë parasysh se MDIS është duke marrë përsipër përgjegjësinë dhe për investime strategjike, duke ndihmuar ministrin për idetë eventuale për investime nga biznesmen të diasporës nga komunitetet joshumicë të Republikës së Kosovës, duke respektuar dispozitat e ligjit, normat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, dhe duke i përfshirë përfaqësuesit e komunitetëve lokal.

Propozim shtesë:

1. Të kemi parasysh shpeshherë që në të gjitha aktivitetet dhe subvencionet nga MDIS të përfshihen edhe shoqatat e komunitetit joshumicë në diasporë dhe mbrenda shtetit.

2. Duke marrë parasysh që MDIS në staf civil nuk janë të mjaftufshëm të punësuar, përfaqsesit e komunitet joshumicë, dhe duke bazuar në dispozitat ligjore, propozioj të punësohet edhe minimum dy punëtor në administratë, prej të cilave një do të jetë nga komuniteti boshnjak.

Data: 07. 12. 2017.

Zv. Ministër Çerim Bajrami

